
REFLEXIONS ON THE IMPORTANCE OF GRAMMAR TEACHING IN A FOREIGN LANGUAGE

Eliana Laçe

Faculty of Foreign Languages, University “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Albania elacej@unishk.edu.al

Abstract: The impact that knowledge of the foreign language rules, object of study, has on the development of the use competence, is one of the core joints of Glottodidactics. It should be emphasized that the foreign language teacher must enter the classroom with a high level of required and more up-to-date knowledge, but not only. He/she should have the ability to reflect on the modalities of knowledge transmission and of competencies acquisition as the ability to reflect on complex problems of didactic mediation. The foreign language teacher’s psycho-socio-pedagogical education should enable him/her to be oriented towards different age groups and allow him/her to operate both in the field of problems related to interpersonal relationships at school and in finding appropriate educational ways to promote didactic success for which he/she has been trained. In the field of foreign language learning, there has currently been a controversy, perhaps prone to remain open to discussion, about the impact that knowledge of the foreign language rules- object of study has on developing the competence of the use of this language. The “Grammar” issue, a term which means not only the explicit and deliberate recognition of the language system rules, but also the ability to use them implicitly, intuitively and subconsciously, will be presented through this paper in the glottodidactic context, by presenting and trying to clarify a series of questions which, notably recently but also in the future, will be a constant companion of a foreign language teacher’s mission. For this purpose, and for the foregoing, a need for teacher training arises, because it is crucially important to make teachers aware of the fact that the use of information technology should not be understood simply as a technical skill but a skill dressed up in a pedagogical significance, as a work organization, as a collaboration with colleagues, as a source of the implementation of didactic and multimedia materials which can be used in the classroom, enabling learners to love Grammar. Through this paper I will try to address the grammar teaching in the glottodidactics context by presenting the basic principles and factors contributing to the determination of the numerous orientations in foreign language teaching, by concretizing it with the experience of the students of professional master's degree in teaching.

Keywords: teacher, learner, Grammar, linguistic reflection, orientation, methodology.

REFLEKSIONE MBI RENDESINE E MESIMDHENIES SE GRAMATIKES NE GJUHEN E HUAJ

Eliana LAÇEJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër elacej@unishk.edu.al

Ndikimi që njohja e rregullave të gjuhës së huaj objekt studimi luan në zhvillimin e kompetencës së përdorimit përbën një nga nyjet thelbësore të glotodidaktikës. Duhet theksuar se mësuesi i gjuhës së huaj duhet të hyjë në klasë me një nivel të lartë të njohurive që kërkohen dhe për më tepër të përditësuara. Ai duhet të ketë mundësinë e të reflektuarit mbi modalitetet e përcjelljes së njohurive dhe të përfuturit të kompetencave si mundësia e të reflektuarit ndaj problematikave komplekse të ndërmjetësimit didaktik. Formimi i tij psiko-socio-pedagogjik duhet ta bëjë të aftë që të orientohet drejt fashave të ndryshme të moshës dhe t’i lejojë të operojë sa më mirë si në drejtimin e problemeve që lidhen me marrëdhëniet ndërpersonale në shkollë ashtu edhe në gjetjen e mënyrave edukative të përshtatme për të promovuar suksesin didaktik për të cilin është formuar. Në fushën e të mësuarit të gjuhëve të huaja aktualisht po zhvillohet një polemikë, ndoshta e destinuar që të mbetet gjithmonë e hapur për diskutim, rreth ndikimit që njohja e rregullave të gjuhës së huaj luan në zhvillimin e kompetencave të përdorimit të kësaj gjuhe. Çështja “gramatikë”, një term me të cilin nënkuptohet si njohja eksplicite dhe deliberative e rregullave të sistemit gjuhësor, ashtu edhe aftësia e përdorimit të tyre në mënyrë implicite, intuitive dhe subkonshe do të paraqitet përmes kësaj kumtese në kontekstin glotodidaktik duke shtruar dhe duke u përpjekur që të sqarohen një sërë pyetjesh të cilat, sidomos kohët e fundit, por edhe në të ardhmen do të jenë një shoqërues i vazhdueshëm i misionit të mësuesit të gjuhës së huaj. Për këtë qëllim lind nevoja e formimit të mësuesve, pasi mbetet një pikë thelbësore shumë e rëndësishme ndërgjegjësimi i mësuesve me faktin që përdorimi i teknologjive nuk duhet të kuptohet thjeshtë si një aftësi teknike, por një aftësi e veshur me domethënie pedagogjike, si një organizim i punës, si një bashkëpunim me kolegët, si një burim i implementimit të materialeve didaktike dhe multimediale që mund të përdoren në klasë duke bërë të mundur që nxënësit të

mos e shohin syshtrembër gramatikën. Përmes kësaj kumtese do të përpiqem të trajtoj mësimdhënien e gramatikes në kontekstin glotodidaktik duke paraqitur parimet bazë dhe faktorët që kontribuojnë në përcaktimin e orientimeve të shumta në mësimdhënien e gjuhëve të huaja si dhe duke e konkretizuar me përvojën me studentët e masterit profesional në mësuesi.

Fjalët kyçe: mësues, nxënës, gramatikë, refleksion gjuhësor, orientim, metodologji.

HYRJE

Ky punim trajton mësimdhënien e gjuhës së huaj dhe pikërisht atë të gjuhë italiane. Vitet e fundit ka pasur tentativa të shumta me qëllim perfeksionimin e metodave të mësimdhënies së gjuhëve të huaja në zbatim të arritjeve bashkëkohore të shkencës së gjuhësisë në këtë kuadër. Përmes këtij punimi dëshiroj të paraqes opinionin tim personal dhe, pse jo, të shtroj edhe për diskutim rëndësinë që zë gramatika në nxënien e një gjuhe të huaj dhe nevojën që lind për ta përshtatur atë me qëllimin kryesor të mësimin të gjuhës së huaj, me komunikimin.

Të gjithë ne jemi ndeshur, gjatë përvojës sonë formuese, me konceptin e gramatikës; shpesh ky koncept përputhet, sipas një opinioni sipërfaqësor dhe mjaft të përhapur, me “rregullat e gjuhës” të cilat i japin mundësinë nxënësit/studentit që ta flasë atë saktë.

Gramatika, vazhdimisht, ka përfaqësuar pjesën më të bezdisshme dhe të rëndë të të nxëniet të një gjuhe të huaj. Çdokush që ka mësuar një gjuhë të huaj është përballur me këtë vështirësi, e cila është sa teknike, pasi faktikisht duhet mundë për të mbajtur mend rregullat gramatikore, format foljore, consecution temporum, po aq edhe psikologjike. Ekziston përshtypja që gramatika bllokton komunikimin tonë, pasi pjesës më të madhe të bashkëbiseduesve u pëlqen të komunikojë sa për t’u kuptuar. Por gjërat nuk funksionojnë në këtë mënyrë. Nëse ne do të flasim me përafësi një gjuhë, po me përafësi do të na kuptojnë të tjerët. Prandaj është shumë e rëndësishme të njohim rregullat e një gjuhe që të mund ta përcjellim saktësisht mendimet dhe idetë tona, meqenëse të folurit është pasqyra e asaj çfarë kemi në mendje.

1. GRAMATIKA DHE REFLEKTIMI GJUHËSOR

Në glotodidaktikën e sotme, me sa duket për arsyt e mësipërme, mund të flitet për një “rikthim të gramatikës” pas vitesh e vitesh të tëra të zbatimit të një mësimdhënieje të bazuar mbi parimet e komunikimit. Një kthim jo tek mësimdhënia tradicionale e gramatikës, por tek një koncept i ri i të bërit gramatikë, tek refleksimi gjuhësor i cili ringjall rëndësinë e njohjes së rregullave të funksionimit dhe të strukturës së një gjuhe.

“reflektimi [...] luan një rol esencial në modelet e formimit të mësuesve. Përmes reflektimit arrijmë të gjejmë lidhjet mes aspekteve dhe momenteve të një përvoje të caktuar dhe bashkëlidhen shkaqet dhe origjinat e veprimeve me rezultatet e tyre. [...] Të formosh profesionalisht mësuesit do të thotë t’i ndihmohet që të distancohen nga praktikat e tyre dhe të kërkojnë të interpretojnë atë çfarë ndodh në klasë” (Ciliberti 2003: 14-14)

Për të bërë më të qartë dallimet dhe të përbashkëtat që raportohen mes gramatikës dhe reflektimit gjuhësor, në këtë ndërhyrje do të mbështetem në përvojën time si pedagoge e lëndës “Didaktikë e gramatikës italiane”. Moduli i didaktikës së gramatikës perceptohet nga pjesa më e madhe e studentëve si një hap bazë dhe thelbësor që ata duhet të përmbushin, jo dhe aq lehtë, në rrugën drejt përfundimit të masterit profesional në mësuesi, i cili përgatit mësues të gjuhës italiane.

Përmes këtij moduli synoj jo vetëm që studentët të përvetësojnë nocionet dhe aftësitë që do t’u nevojiten në profesionin e tyre të ardhshëm si mësues, por përpiqem t’i shtyjë sidomos drejt kryerjes së një reflektimi kritik gjuhësor.

Përsa i takon grupit të studentëve, gjatë punës sime kam arritur në përfundimin se nga njëra anë qëndrojnë ata që e shohin gramatikën si një sistem rregullash të ngurta dhe të fiksuara, bazë për zhvillimin e mësimin të një gjuhe dhe si elementin më të rëndësishëm ndër përbërësit e tjerë si leksiku, fonetika etj. Për këtë grup të mësuarit e një gjuhe të huaj do të thotë, sidomos, zotërimi i elementeve morfosintaksore të saj. Nga ana tjetër pozicionohen ata studentë të cilët e konsiderojnë gramatikën si element i parëndësishëm pasi mbrojnë mendimin se, edhe pa e njohur “mirë” atë, mund të kryhet procesi i të folurit duke u kuptuar më së miri. Për këtë grup të dytë, të mësosh një gjuhë të huaj do të thotë sidomos të arrish synimin komunikues, edhe pse në mënyrë jo të përkryer.

Për të mundësuar arritjen e qëllimit të vërtetë të modulit të didaktikës së gramatikës, është shumë e rëndësishme dhe thelbësore dhënia e përgjigjes pyetjeve të mëposhtme :

- 1- Përse duhet që mësuesit t’u mësojnë nxënësve apo studentëve të tyre gramatikën e një gjuhe? Studimet sugjerojnë që për të zhvilluar në nivele të larta saktësinë gjuhësore është e nevojshme që nxënësit të fokusohen në format gjuhësore. Këto studime kanë treguar që mësimdhënia që fokusohet në formën gjuhësore kontribuon pozitivisht në përvetësimin e gjuhës dhe kanë kontribuar në rritjen e rolit të gramatikës në përvetësimin e gjuhës.

- 2- Në ç'mënyrë mësuesit mund t'u mësojnë nxënësve apo studentëve të tyre gramatikën? Çështja në diskutim tani nuk është nëse mësimdhënia duhet të fokusohet në gramatikë, por si të mësohet gramatika në mënyrë efektive për një komunikim të suksesshëm.
- 3- A është më mirë të fillohet me dhënie e rregullit gramatikor e më pas zbatimin e saj përmes një vargu ushtrimesh (qasje deduktive) apo të fillohet me një input gjuhësor (një tekst të shkruar, një regjistrim audio, qasje induktive) dhe t'u kërkohet nxënësve/studentëve të reflektojnë në mënyrë aktive rreth gjuhës dhe të formulojnë hipoteza me qëllim gjetjen e formave të rregullta të cilat më pas do të sistemohen nga mësuesi dhe do të përforcohen përmes ushtrimeve tipike (Andorno, Bosc, Ribotta 2003: 46)? Shumë studies kanë hulumtuar nëse mësimdhënia eksplicite apo ajo implicite është më e dobishme për nxënësit. Duke iu referuar disa prej tyre, gjejmë që mësimdhënia eksplicite është pranuar si superiore në përvetësimin e gjuhës ndaj asaj implicite për sa i përket sasisë, saktësisë dhe progresit në përvetësimin e formave gramatikore. Por pavarësisht këtyre rezultateve, efektiviteti i mësimdhënies eksplicite dhe asaj implicite mbetet një çështje e hapur.

Disa elemente kyçe të cilët mendoj se mund të përfshihen në modulën e didaktikës së gramatikës dhe që mund të përbëjnë një objektiv të rëndësishëm të mësuesve të ardhshëm lidhen me:

- 1- Domosdoshmërinë e nxitjes së reflektimit ndaj faktit që jo e gjithë gramatika duhet medoemos t'u ofrohet nxënësve/studentëve në mënyrë eksplicite.
- 2- Shkallëzimi, pra jo të gjitha aspektet e gjuhës duhet të ofrohen nga mësuesi në të njëjtën mënyrë. Studentët tanë, si mësues të ardhshëm, duhet të kenë të qartë që nuk mund t'u mësohet nxënësve "gjithçka dhe menjëherë" por, përkundrazi, duhet të punohet sipas një rruge në formë spirale në mënyrë që pak nga pak t'u rikthehet dhe të zgjerohet argumentet e trajtuara (Andorno 2006: 100-102).
- 3- Ndërgjegjësimi që ajo çfarë ne si mësues ofrojmë nuk do të përftohet dhe vihet në jetë menjëherë nga nxënësit/studentët tanë.

Në glotodidaktikën e gramatikës paraqitet shumë thelbësor koncepti i "përfaqësimit mendor" sepse bën të mundur që nxënësi/studenti ta zotërojë në mënyrë të ndërgjegjshme atë çfarë ai ka përfutur spontanisht si dhe të jetë i pavarur gjatë fazës së nxënies. Pra, në këtë rast mund të flasim për atë që ndryshe quhet "njohje e një veçorie të caktuar gjuhësore". Njohja e veçorive të sistemit gramatikor përmes proceseve mendore do të rezultojë gradualisht në produkt të saktë e të përshtatshëm gjuhësor. Një njohje e tillë realizohet jo vetëm përmes mësimdhënies formale të formave të caktuara por gjithashtu edhe nëpërmjet ekspozimit të vazhdueshëm ndaj komunikimit. Sapo rritet ndërgjegjja e nxënësit për një veçori, nxënësi tenton të vërejë veçorinë në informacionin e radhës. Kur një çështje gjuhësore vihet re shpesh, nxënësi krijon njohjen e saj dhe në mënyrë të pavetëdijshme e krahason atë me sistemin ekzistues të njohurive gjuhësore dhe ndërton hipoteza të reja për të akomoduar ndryshimin mes informacionit të vërejtur dhe aftësisë së tij gjuhësore. Shumë mësues dhe ekspertë besojnë që pjesëmarrja në ndërveprime e veprimtari që çojnë në rritje të produktivitetit gjuhësor kontribuon në përvetësimin e njohurive të gjuhës së huaj (përfshirë dhe ato gramatikore).

Duke iu rikthyer edhe një herë dy metodave, pra nëse duhet të zbatohet mësimdhënien e gramatikës(1) apo reflektimin gjuhësor (2) po i referohem Balbonit ndërsa sjell një skemë e cila përmbledh më së miri ndryshimet kryesore midis këtyre dy metodave:

- Kë dhe Çfarë? : (1) Mësuesi paraqet rregullat në kuadrin e normave që duhen pranuar; (2) Nxënësi/studenti nën drejtimin e mësuesit zbulon mekanizmin e funksionimit të gjuhës.

- Kur?: (1) Realizon pikënisjen. (2) Realizon pikëmbritjen.

- Ku dhe Pse?: (1) Rregullat vendosen brenda skemave të parapërcaktuara nga mësuesi ndërsa nxënësi/studenti është në pozicionin e tij pasiv. (2) Funksionimi brenda skemave boshe, të parapërcaktuara për të drejtuar nxënësit/studentët drejt të reflektuarit nëkohë që ky nxënës/student është në pozicionin e tij aktiv.

- Motivimi dhe Teknikat: (1) Mësimdhënia është më e lehtë dhe më e shpejtë se sa procesi kërkimor, është më e plotë dhe e saktë. (2) Procesi kërkimor është kënaqësi primare.

Për të ndihmuar nxënësit/studentët që të reflektojnë rreth elementeve gjuhësore në mënyrë që të krijojnë proceset mendore të njohurive të tyre, Korder propozon ushtrime që çojnë drejt zbulimit të rregullat: ushtrime të tipit induktiv; verifikim të rregullave: ushtrime me alternativë, ushtrime zëvendësimi dhe plotësimi; përvetësim të rregullave: pattern drills, sequenca e pattern, përsëritja, përforsimi i menjëhershëm.

Mund të ndodhë që disa aspekte të gjuhës të përftohen në mënyrë implicite, që "ndërgjuha të zhvillohet përmes thithjes, përsëritjes dhe zgjerimit të rutinave gjuhësore të marra nga nxënësit në rrugë induktive vetëm përmes ekspozimit ndaj inputit, pa qenë nevoja që mësuesi të zbërthejë, të analizojë dhe të shpjegojë rregullat që qëndrojnë pas formulave atëherë kur nxënësi/studenti nuk është akoma gati" (Rastelli 2009: 107-108). Për këtë arsye, vazhdimisht është nënvizuar nevoja për të punuar me formulat që kanë frekuencë të lartë, me përdorimin e tyre dhe të ushtruarin sipas kontekstit, me qëllim krijimin e kushteve në mënyrë që disa tipare morfosintaksore të evidentohen e të fitohen në mënyrë implicite (Rastelli 2009: 59-60).

Debeto pohon se momenti i reflektimit gjuhësor është i nevojshëm prandaj është e rëndësishme që mësuesi të arrijë ta vendosë atë në një kontekst kulturor, brenda tekstit – këshillon eliminimin e fjalive të shkurtra – duke parapëlqyer mënyrat e përdorimit dhe duke respektuar metodën e arritjes shkallë – shkallë.

Studiuesit kanë sugjeruar detyra për qëllime komunikative me fokus strukturën e gjuhës me synimin e ndërgjegjësimit të nxënësve për strukturën gramatikore dhe praktikimin e tyre. Ellis i ka grupuar këto detyra në tre lloje:

- Detyra që fokusohen në struktura komunikative të gjuhës, të cilat i kërkojnë nxënësve të përdorin formën e synuar gramatikore për të realizuar veprimtarinë komunikuese.

- Detyra të zhvillimit të kuptimit, të cilat synojnë të aftësojnë nxënësit të dallojnë dhe të kuptojnë veçorinë gramatikore në kontekstin komunikativ.

- Detyra të rritjes së ndërgjegjësimit, të cilat i kërkojnë nxënësve të komunikojnë direkt nëpërmjet strukturave gramatikore.

Ndërsa Nassaji dhe Fotos i ndajnë detyrat më fokus gramatikën në dy lloje:

- Detyra eksplicite të cilat synojnë, që pas dhënies së rregullit gramatikor, të rritin vëmendjen e nxënësve të veçoritë gramatikore, dhe t'i kuptojnë ato në materialin e dhënë. Gjithashtu ato synojnë të nxitin nxënësit të korrigjojnë ligjërimet e tyre për sa i përket çështjes së synuar gramatikore.

- Detyra implicite synojnë të nxitin nxënësit të dallojnë dhe të kuptojnë çështjen gramatikore në kontekstin e komunikimit. Për shembull, pas dhënies së disa shembujve të një strukture dhe angazhimit të nxënësve në veprimtari për të kuptuar atë strukturë, nxënësit komunikojnë me strukturën në fjalë për të qartësuar ose kuptuar më mirë atë, madje mund t'ju kërkohej të artikulojnë rregullin për ta përshkruar atë. Për më shumë, studiuesit kanë arritur në përfundime që zgjedhja e strategjisë së mësimdhënies së gramatikës ndikohet nga një numër faktorësh: a) Gjuha amtare e nxënësve; b) Spikatja e formës gjuhësore në ligjërim; c) Shpeshësia e veçorisë gramatikore në input; ç) Kompleksiteti i rregullit; d) Stili individual i të mësuarit; dh) Mosha e nxënësve; e) eksperiencia e mëparshme në mësimin e gjuhës.

2. KONKLUZIONE DHE SUGJERIME

Nga sa më sipër rrjedh që nuk mund ta vlerësojmë “vlerën” e mësimdhënies së gramatikës vetëm duke u bazuar në faktin se sa qartë një mësues e paraqet rregullin gramatikor në tabelë; përkundrazi, janë të shumtë faktorët e tjerë që, në mësimdhënës, duhet të marrim në konsideratë nëse duam ta bëjmë qëndrimin tonë në klasë sa më efikas që të jetë e mundur. Ndër to mund të përmendim: feedback-un sa më eksplicit, evidentimin e disa tipareve të gjuhës përmes ngritjes së tonit të zërit (auditory recast) ose trajtimin grafik të formave (visual enhanced input), zgjedhjen e ushtrimeve që do të paraqiten në klasë etj. (Rastelli 2009, kap. 3)

Të fshijmë nga kujtesa manualët e vjetër dhe të ngurtë, plot rregulla të pakapërcyeshme e parashkrime të pakuptueshme dhe të nxisim përfundimisht gramatikën e gjeneratës së re, atë *pop*, të gëzueshme, shumëngjyrëshe, konkrete, joshëse, dinamike, të gjallë e argëtuese. Në fund të fundit, po ta shohim mirë, gramatika nuk është veçse një lojë dhe si e tillë ka rregullat e veta; si e tillë matë shkathhtësinë, nxit intelektin, zhvillon aftësitë, ndihmon në zotërimin më mirë të gjendjeve emocionale, bën më të rrjedhshëm komunikimin, qetëson shpirtin, dhuron kënaqësi.

Të zgjerojmë temat e gramatikës tradicionale duke u bazuar në punën kërkimore gramatikore duke shtuar variabilitetin, mendimin shoqëror, funksional dhe historik të gjuhës.

Të vendosim objektivat e rëndësishme që nxisin rolin e të menduarit gjuhësor: - zhvillimi konjitiv; - zhvillimi i aftësive gjuhësore; - potencial për formimin kulturor të nxënësit/studentit.

Në përmbyllje të gjithë kësaj analize rreth vendit që duhet t'i jepen dhe përzgjedhjes që duhet t'i bëhen dy metodave të mësimdhënies, gramatikës dhe reflektimit gjuhësor, I lejoj vetes të ofroj disa këshilla për mësuesit e ardhshëm: Bëjani vetes çdo herë pyetjen: Për çfarë kanë nevojë nxënësit e mi sot? Shpjegoni atë çfarë nevojitet në momentin e caktuar. Bëjani mësimin sa më të thjeshtë. Asnjëherë mos pushoni së drejtuar vëmendjen ndaj elementeve gramatikore sipas kontekstit. Mos harroni që përvetësimi ka nevojë të marrë kohën e vet. Nëse vini re që argumenti gramatikor rezulton i vështirë, kaloni tek punimi me shkrim. Kufizoni korrigjimin e gabimeve gramatikore. Mos harroni që gramatika mund të jetë edhe argëtuese, prandaj propozoni vazhdimisht aktivitete ludike. Si përfundim, duhet të krijoni bindjen që t'u mësosh nxënësve gramatikën nuk është një zgjedhje që mund të bëhet ose jo nga ana e mësuesit apo teksteve, por një pjesë esenciale e çdo kurrikule të gjuhës së huaj.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Andorno, C., (2006), “*La lingua degli apprendenti dal punto di vista delle varietà di apprendimento.*” In: C. Marengo, S. Mosca & F. Bosc (a cura di). *Saperi per insegnare. Formare insegnanti di italiano per stranieri.* f. 86-111. Torino, Loescher.

- [2] Andorno, C., (2008), *“Insegnare e imparare l'italiano L2: quale grammatica?”* f.123-142. Perugia, Guerra.
- [3] Balboni, P., (1994), *Didattica dell'italiano quale lingua straniera*, Roma, Bonacci Editore.
- [4] Balboni, P.E. (2008), *Le sfide di Babele – Nuova edizione*, Torino, UTET.
- [5] Bettoni, C., (2001), *Imparare un'altra lingua.*, Roma/Bari, Laterza.
- [6] Ciliberti, A., (1994), *Manuale di glottodidattica*, Scandicci (Firenze), La Nuova Italia.
- [7] Ciliberti, A. (2003), Introduzione, in Ciliberti A., Pugliese R., Anderson L., *Le lingue in classe*, Roma, Carocci, f. 11 – 20
- [8] Cipriani, P., Chilosi, A.M., Bottari, P. e Pfanner,(1993), *L'acquisizione della morfosintassi in italiano. Fasi e processi.*, Padova, Unipress.
- [9] Debetto, G., (2016), *La lingua italiana e le sue regole. Grammatica con esercizi*, Loescher Editore.
- [10] Lo DUCA, M.G. (1997), *“Esperimenti grammaticali. Riflessioni e proposte sull' insegnamento della grammatica dell' italiano.”* Firenze, La Nuova Italia.
- [11] Lo Duca M.G. (2003), *Lingua italiana ed educazione linguistica*, Roma, Carocci
- [12] Giacalone Ramat, A. (a cura di), (1986), *“L'apprendimento spontaneo di una seconda lingua.”* Bologna, il Mulino.
- [13] Nassaji, H., Fotos, S., (2011) *Teaching Grammar in Second Language Classrooms: Integrating formfocused instruction in communicative context.* Routledge Taylor & Francis Group, f. 55.
- [14] Rastello, S. (2009), *“Che cos'è la didattica acquisizionale.”* Roma, Carocci Editore.